



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E KULTURËS
KËSHILLI KOMBËTAR I TRASHËGIMISË KULTURORE MATERIALE

Nr. 1504 Prot.

Tiranë, më datë 12.10.2021

VENDIM
Nr. 619, datë 12.10.2021

Në mbështetje të Ligjit Nr. 27, datë 17.05.2018 “Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë”, neni 38, pika 2, V.K.M Nr. 208, datë 10.04.2019 “Për Përbërjen, Mënyrën e funksionimit, Kompetencat dhe Shpërblimin e Anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore Materiale”, Vendimit Nr. 792, datë 7.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve dhe të kriterëve të posaçme të licencimit, dokumenteve shoqëruese, nënkategorive të licencave, procedurave për dhënien, pezullimin ose revokimin, si dhe kuotizacionit vjetor të licencave për ndërhyrjet në pasuritë kulturore materiale”, ndryshuar me Vendim Nr. 329, 02.06.2021, pas shqyrtimit më parë të kërkesës në Këshillin Teknik, Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale, në mbledhjen e datës 12.10.2021:

VENDOSI:

- Miratimin e kërkesës së *Znj. Liri Shehaj* për pajisjen me licencë individuale në mbikëqyrje dhe kolaudim (MK), në veprimtari ndërhyrëse në pasuritë kulturore materiale, në kategoritë (A), sipas nënkategorive të reja:
 - MK/A/1. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i rrënojave/siteve arkeologjike;
 - MK/A/2. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve me karakter mbrojtës;
 - MK/A/3. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së kultit;
 - MK/A/4. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i ndërtimeve inxhinierike;
 - MK/A/5. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së traditës (vernakulare);
 - MK/A/6. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim dhe restaurim i arkitekturës së projektuar;
 - MK/A/7. Mbikëqyrje dhe kolaudim në konservim, restaurim dhe rikualifikim i hapësirave (rrugë, sheshe) brenda qendrave historike dhe ansambleve historike urbane.
 - Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij Vendimi;
 - Ndaj Vendimit mund të ushtrohet ankimi në gjykatën kompetente për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi nuk pezullon zbatimin e aktit administrativ.
- Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETAR
Arta DOLLANI

